



Nr. 31 prot
Shkollën 14/06/12

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 22 Datë 07.03.2018

**PËR MOSMIRATIM NË PARIM TË KËRKESËS PËR PËRDORIM TË BURIMIT
UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE SUBJEKTIT "SAZAN- TOTA" SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, " Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni", për paisjen me autorizim (miratim në parim) të subjektit "**SAZAN- TOTA**" sh.p.k., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

- 1- Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit "**SAZAN - TOTA**" shpk, me administrator Z.Remzi TOTA, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Gjegje dhe Përroi i Ahut** , për prodhim energjie elektrike (HEC GJEGJE), në Fshatin Bushtricë, Njësia administrative Bushtricë, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.
- 2- Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyet e mëposhtme:
 - Shkatërron mjedisin dhe turizmin
 - Vështirësonte jetën sociale dhe ekonomike të banorëve me cënimin e ujit të pijshëm dhe ujit për nevojat e bujqësisë në zonë.
- 3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLJA

